

**KANIONI I LUMIT TË CEMIT XHEVAHIR
I FSHEHUR I NATYRËS DHE KULTURËS**



Parqet Dinarida, pra rrjeti i zonës së mbrojtur Dinarida, është i përkushtuar për përparimin e vlerave natyrore dhe kulturore të zonave të mbrojtura Dinarida, promovimin dhe mbështetjen e tyre, si edhe zbatimin e praktikave të mira të zhvillimit të qëndrueshëm dhe menaxhimit. Rrjetin e parqeve Dinarida e përbëjnë më shumë se 100 zona të mbrojtura në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi, Kroaci, Kosovë*, Maqedoninë e Veriut, Slloveni dhe Serbi.

Për përmbajtjen e kësaj broshure, përgjegjësi mban vetëm OJQ-ja Parqet Dinarida.

* Ky emërtim është bërë pa paragjykime për pozitën ose statusin, si edhe në përputhje me RKSOKB 1244/99 (Rezoluta 1244/99 e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara) dhe mendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës



CEMI

Ky lumë malor, me pragjet e tij, ujëvarat dhe ujin e ftohtë, lë gjurmë në hapësirë dhe kohë dhe përcakton identitetin e njerëzve të kësaj zone. Ai është pjesë e pandarë e jetës së tyre. Ai përbën një kult. Që nga kohërat të lashta e deri më sot, si i tërheq njerëzit me qartësinë kristale dhe forcën e tij, i adapton ata me ftohtësinë e tij dhe i bën të fortë ashtu siç është edhe ai vetë.

Lumi i Cemit buron në Shqipëri. Ai formohet nga bashkimi i Cemit të Selcës (mne. Cijevna Seljce) dhe Cemi i Vuklit (mne. Cijevna Vuklja), në rrjedhën e poshtme të vendbanimit të Tamarës (mne. Tamare). Ai derdhet në lumin Moraça, në territorin e Malit të Zi dhe i përket basenit të liqenit të Shkodrës, i cili, së bashku me lumin Buna, i përket basenit të detit Adriatik. Cemi është lumi më i madh në rajonin e Bjeshkëve të Namuna. Ai është e gjatë 58.8 km. Ai shtrihet në Shqipëri me një gjatësi prej 26.5 km, dhe 32.3 km në Mal të Zi, duke lidhur kështu liqenin e Shkodrës me Bjeshkët e Namuna.

E gjithë rrjedha e lumit na paraqet rrëmbyeshmërinë dhe paparashikueshmërinë e tij, por edhe atë që ai është tërheqës dhe miqësor. I përshtatur me atë që brigjet e tij janë një luginë e ngushtë mes maleve, edhe aty ku kanioni takon një fushë të pafund dhe të duket sikur do të humbasë në të, Cemi nuk ja lejoi vetes që të shndërrohej në një lumë të qetë fushor. Ai vazhdon të rrjedhë siç është mësuar dhe gjen mënyrën për të kaluar në një grykë, një pjesë e të cilës është aq të ngushtë sa një kajaker nuk mund ta përdorë rremin, por mund të ndjekë rrjedhën e lumit vetëm duke iu dorëzuar atij.

Me diversitetin e saj biologjik, gjeomorfologjik dhe në shumë baza të tjera, Cemi me kanionin e tij, dëshmon atraktivitetin dhe veçantinë e tij, dhe prandaj e justifikon statusin e tij për të qenë i mbrojtur në Mal të Zi. Me shpalljen e tij monument natyre, u hodh një hap i një rëndësie të madhe në rrugën e qëndrueshmërisë, duke treguar nevojën për ta shpallur atë një zonë të mbrojtur edhe nga pala shqiptare. Në këtë mënyrë, në tërësinë dhe unitetin e tij, atraksionet e Cemit dhe kanionit të tij u gjetën në hartën e destinacioneve turistike të rëndësishme, duke konfirmuar se as natyra dhe as vizitorët nuk njohin kufij.



KANIONI I CEMIT - ZONË E MBROJTUR

Karakteristikat dhe veçoritë e jashtëzakonshme natyrore e bëjnë zonën e kanionit të lumit të Cemit që të jetë i njohur në Mal të Zi dhe më gjerë. Rëndësia shkencore e këtij kanioni, si dhe zonave të ngjashme të tipit refugial në Mal të Zi, reflektohet në shkallën e lartë të ruajtjes dhe specifikës natyrore. Është i vlefshëm për kërkime natyraliste që mund të japin përgjigje për çështje të shumta aktuale mjedisore, ndryshe nga zona të ngjashme në Gadishullin Ballkanik dhe në Evropë, ku janë degraduar pjesërisht ose plotësisht ose madje janë shkatërruar.

Falë këtyre veçorive, kanioni i Cemit u shpall në vitin 2017 zonë e mbrojtur në Mal të Zi në kategorinë monument natyre. Për më tepër, ajo njihet si një zonë e rëndësishme për bimët - Zona IPA (Zonat e rëndësishme të bimëve) dhe një zonë e rëndësishme për shpendët - zona IBA (Zonat e rëndësishme të shpendëve), dhe sipas dispozitave të Konventës së Bernës ajo u shpall gjithashtu zonë EMERALD. (ME0000008).



BIODIVERSITETI I KANIONIT TË CEMIT

FLORA

Flora e plotë e kanionit të lumit të Cemit u përpunua nga Bulić (1993, 1994, 1998) - si pjesë e tezës së tij të magistraturës - i cili, bazuar në të dhënat e tij kërkimore dhe shkencore, përmend 813 lloje të florës vaskulare, ndërsa për të gjithë kanionin 959 lloje. Pas vitit 1994, të dhëna të rëndësishme floristike të zonës së lumit të Cemit mund të gjenden në veprat e Hadžiablahović (2004a, 2004b, 2010) dhe Hadžiablahović & Bulić (2004).

Flora e kanionit të lumit të Cemit karakterizohet nga një shkallë e lartë endemizmi, gjë që i jep kësaj zone një rëndësi të veçantë për ruajtjen e saj. Prania e specieve endemike dhe relikte tregon rëndësinë e kanionit të Cemit si refugium dhe ato paraqesin dëshmi të zhvillimit historik të botës bimore (sepse zakonisht janë paleoendemikë) si edhe janë objekt i kërkimeve multidisiplinare.

Llojet relike të pranishme në kanionin e Cemit:

- *Pinus heldreichii*, Rrobulli,
- *Quercus trojana*, Lisi maqedonas
- *Moltkea patraea*, Bliri gjethengushtë,
- *Ramonda Serbica*, *Ramonda serbe*,
- *Edraianthus tenuifolius*, Lule zile me gjethe të ngushta,
- *Edraianthus Ginzbergeri*, Kambana e Ginzbergerit,
- *Iris illyrica*, Iri ilir,
- *Campanula pyramidalis*, Zilja piramidale,
- *Rhamnus orbiculata*, Druri i qenit me gjethe të rrumbullakëta.



ICHTHIOFAUNA

Lumi i Cemit është shtëpi e llojeve shumë të rëndësishme dhe të rralla të peshqve. Sipas të dhënave të literaturës, në lumin e Cemit jetojnë lloje të peshqve si: trofta e murrme, thinja, trofta e përrenjëve, peshk i sheshtë, ngjala, cigani italian, sardelja. Shumë prej tyre janë endemike, që gëzojnë mbrojtje ndërkombëtare. Diversiteti i llojeve të peshqve, përveç aspektit ekologjik, është shumë i rëndësishëm edhe për zhvillimin e turizmit në këtë zonë. Por, parakusht për zhvillimin e turizmit është mbrojtja e natyrës, pra ruajtja e këtyre specieve, nëpërmjet zbatimit të masave konkrete mbrojtëse në terren.

ORNITOFAUNA

Kanioni i Cemit është një nga habitatet më të rëndësishme për zogjtë grabitqarë dhe një vend i rëndësishëm folezimin për disa lloje dallëndyshesh dhe specie të mbrojtura shpendësh. Kjo pasuri, përveç rëndësisë që ka në mbrojtjen e faunës së shpendëve në

Mal të Zi dhe Evropë, ka vlerë edhe në punën kërkimore dhe zhvillimin e ekoturizmit. Këtu u konfirmua folezimi i shqiponjës tullace, (*Aquila chrysaetos*); shqiponjës së gjarpërinjve, (*Circaetus gallicus*); sokoli i zakonshëm, (*Buteo buteo*); fajkoi i zakonshëm, (*Falco tinnunculus*); fajkoi i dallëndysheve, (*Falco subbuteo*); skifteri, (*Accipiter nisus*). Mbi këtë kanion shtrihet një brez i gjerë terreni kodrinor me një pjerrësi të lehtë të mbushur me makie dhe bimësi të rrallë, ku thëllëza shkëmbore, (*Alectoris graeca*), gjen vendin më optimal për folezimin e saj.

KARAKTERISTIKAT GJEOLGJIKE DHE GJEOMORFOLOGJIKE TË KANIONIT TË CEMIT

Historia gjeologjike e kësaj zone të çon prapa në Mesozoik. Shkëmbinjtë mezozoikë të të gjitha seksioneve të Triasikut, Jurasikut dhe Kretakut janë më të zakonshmet në kanionin e Cemit, si dhe shkëmbinjtë që i nënshtrohen gëlqerizimit të fortë. Gjatë kësaj periudhe të gjatë gjeologjike, krahas ndryshimit të klimës, në këtë zonë u formuan forma të shumta dhe specifike gjeomorfologjike, duke filluar nga vetë kanioni e duke përfunduar me forma të ndryshme gëlqerore, si edhe të forma tjera të krijuara nga veprimi i forcave erozive dhe akullnajave. Veçoritë gjeomorfologjike dhe hidrologjike të kanionit janë rezultat i strukturës së tij tektonike si dhe tektonikës së zonave rreth tij, si dhe erozioni lumor dhe tërheqja e akullnajave nga Bjeshkët e Namuna. Janë të shpeshta format hidrologjike dhe gjeomorfologjike tipike për holocrastin, si: uljet, rrotullimet, gropat, shpellat dhe gremina, të cilat janë shumë të theksuara në shtratin ku përfundon kanioni. Gjithashtu, janë të pranishme format më të lehta gëlqerore: balta, gërvishtjet, çarjet dhe gurët në të cilat pengohet uji.¹

¹ Studimi i mbrojtjes Monumenti i natyrës Kanioni i Cijevnës



SHPELLAT

Këtë kanion e bëjnë karakteristik një numër gjymëshpellash të vogla e të mëdha, si edhe shpellash. Disa nga shpellat janë të zbukuruara me zbukurime shpellash, ndërsa disa kanë luajtur një rol të rëndësishëm në jetën e popullsisë vendase për shkak të thjeshtësisë dhe qasjes tek to - ato përdoreshin për të ruajtur ushqimin dhe kanë qenë po aq të vlefshme sa "frigoriferët" e sotëm. Këtë praktikë e vërteton edhe shpella e Bigës së Velishes (mne. Biga Veljiša) në fshatin Selishtë (mne. Seljište). Ka edhe shpella ku njerëzit kanë jetuar me bagëti deri në vitet shtatëdhjetë të shekullit të kaluar.



PLAZHET

Brigjet e lumit të Cemit janë të zbukuruara me një numër të madh plazhesh. Gjatë muajve të nxehtë të verës, ato janë vende të pazëvendësueshme grumbullimi, pushimi dhe argëtimi. Ata tërheqin vizitorët me bukurinë e tyre dhe mjedisin tërheqës dhe nuk lënë indiferentë as udhëtarët e synuar.



NATYRA DHE NJERËZIT

Ky mjedis natyror specifik formon frymë dhe zakone specifike. Lumenjtë kanë qenë gjithmonë djepi i jetës dhe i qytetërimit. Traditat thonë se në brigjet e lumit të Cemit, në vendin ku sot ndodhet Dinosa, “çatitë e arta të shtëpive” ishin aq afër njëra-tjetrës sa “një mace mund të hidhej nga çatia në çati”, duke aluduar në zonën e dendur të populluar. Nuk duhet harruar fakti se edhe banorët e Trijeshit, që gjenden lart mbi Cemin, pra jo vetëm banorët e vendbanimeve në afërsi, çdo ditë vinin të merrnin ujë në Cem dhe materiale nga brigjet e tij.

BIMËT MJEKËSORE

Të jetosh në harmoni me natyrën ka nënkuptuar gjithmonë të që duhet të kesh njohuri të ndryshme. Gëlqerorët dhe klima favorizuan praninë e llojeve të shumta të bimëve mjekësore në këtë zonë, kështu që njerëzit i përdornin ato si për qëllime kuruese, ashtu edhe si erëza për gjellët. Sot në këtë zonë kemi edhe plantacione me livando, trëndelinë, rozmarine, bari i bletës dhe specie të ngjashme, dhe mundësia që vetitë mjekësore dhe dobia e këtyre bimëve të jenë pjesë e shenjës autentike të këtij destinacioni.



BLETARIA

Larmia e florës, livadhet dhe kullotat e bollshme përbëjnë kushte të përshtatshme për zhvillimin e bletarisë në këtë zonë. Shumë banorë vendas po i drejtohen bletarisë si një aktivitet ekonomik i qëndrueshëm. Këto biznese familjare jo vetëm që kontribuojnë në ekonominë vendase, por edhe ruajnë traditat dhe përmirësojnë ekuilibrin ekologjik të zonës. Prodhimi i mjaltit, propolisit, dyllit të bletës dhe produkteve të ngjashme u mundëson bizneseve familjare të zhvillojnë brende të njohura, të cilat mund të bëhen pjesë e rëndësishme e ofertës turistike vendase.

VRESHTARIA DHE VERA

Historitë e shumta që kanë të bëjnë me të gjithë komunitetin, si dhe historitë familjare dhe individuale, konfirmojnë se vreshtaria dhe prodhimi i verës janë të rrënjosura thellë në traditën dhe kulturën që është edhe sot e pranishme në këtë zonë. Sipërfaqet mbresëlënëse të mbuluara nga vreshtat, si dhe çdo cep i vogël i tokave që përdoren për mbjelljen e hardhive, pasqyrojnë përkushtimin e popullsisë vendase për punë dhe krijim, si edhe dashurinë për traditën dhe përpjekjen për ta ruajtur atë.

ULLINJTË DHE VAJI I ULLIRIT

Paraardhësit nuk i mbollën ullishte vetëm për nevojat e tyre, por edhe për t'ua lënë ato si dhuratë brezave të ardhshëm. Brezat e sotëm i ruajnë me krenari dhe i punojnë ato për të siguruar jetesën. Rritësit e ullinjve të kësaj treve i kanë vënë vulën personale trashëgimisë në rrënjët e ullinjve si edhe në çdo pikë të vajit të ullirit. Duke ndjekur njohuritë dhe aftësitë që janë përcjellë brez pas brezi dhe aplikimin e teknologjive moderne, ato kanë bërë që zona e komunës së Tuzit të mburret për prodhim cilësor të vajit të ulliri, i kërkuar dhe i njohur ky në treg jo etëm si ushqim, por dhe si një eliksir i vërtetë i shëndetit.



VLERA KULTURORE

MISTIKA E HISTORISË DHE TRADITËS

Gjurmët e kohës së kaluar janë të rrënjosura thellë në kulturën që ekziston në këto zona. Ngjarjet e trazuara historike janë përcaktues për këtë zonë. Dikur ato kushtëzoheshin nga lëvizjet globale dhe në disa raste pikërisht kjo zonë ka qenë djepi i pështjellimeve historike. Rebelimi i vendasve dhe përpjekja e tyre për të fituar lirinë ishte shkëndija e tyre. Sot, në çdo hap, në çdo simbol, në çdo fjalë - të shkruar apo të transmetuar brez pas brezi, gjendet dhe njihet konfirmimi i një historie të gjatë dhe kujtimi i saj është shkruar në kodin e popullsisë së saj. Nga ilirët, përmes romakëve dhe grekëve, e deri në ditët e sotme, në gjuhë, kulturë dhe dëshmi materiale, mund të gjenden mbetje të historisë së pasur të Malësisë.

VEHJET KOMBËTARE TË MALËSORËVE DHE XHUBLETA E UNESCO-S - MË SHUMË SE VESHJE

Xhubleta është një veshje tradicionale komplekse dhe luksoze e grave shqiptare, që përbëhet nga disa shtresa pëlhure, të cilat formojnë një formë specifike në formë zileje ose trapezi, me bel të hollë të theksuar dhe të zgjeruar drejt fundit, gjë që është pothuajse e pamundur të riprodhohet në ditët e sotme për shkak të strukturës dhe simbolikës së saj komplekse. Kjo veshje është prej leshi, dhe është dekoruar me shumë qëndisje, gjeometrike dhe motive të tjera, simbolika e të cilave është një kombinim i simboleve të krishtera dhe pagane. Argjendi, i cili e dekoron në mënyrë të pasur këtë veshje, ka elementë të të gjitha kulturave që kanë kaluar dhe kanë banuar në këtë zonë, madje edhe ato orientale dhe hebraike, e jo vetëm të krishtera. Mendohet se mosha e saj është rreth 4000 mijë vjet. Për shkak të vlerës së saj kulturore dhe historike, Xhubleta u fut në vitin 2022 në listën e UNESCO-s të trashëgimisë kulturore jomateriale.



AQUADUKTI ROMAK

Ai përfaqëson një sistem magjepsës të furnizimit me ujë të lashtë që lidhte lumin e Cemit me qytetin e lashtë romak Dukla (lat. Doclea), që ndodhet afër Podgoricës së sotme. Ky ujësjellës ishte shumë i rëndësishëm për furnizimin me ujë të qytetit të Duklës, i cili ishte një nga qendrat urbane më të rëndësishme në rajon gjatë periudhës romake. Mbetjet e kanalit të Aquaduktit romak janë të dukshme pranë lumit të Cemit në fshatin Dinoshë si dhe në fshatin Omerbozhaj. Ai është gdhendur në shkëmb të gjallë. Gjerësia varion nga 1,35-1,40 m, ndërsa lartësia e kalon 1 m. Baza është në formë katrore, e harkuar me blloqe guri të përpunuar, ku si lidhës është përdorur llaçi hidraulik..



TUMAT PREJ DHEU TË DINOSHËS

Tumat përfaqësojnë monumente varrimi që lidhen kryesisht me periudhën parahistorike dhe me kulturat e bazuara në atë traditë.² Ka 5 tuma dhe në bregun e lumit të Cemit dhe 2 të tjera pranë fshatit Tojeq. Tumat janë me përmasa të vogla dhe mesatare, me diametër 10-22 m dhe lartësi 1,5-3 m.

QYTETI GJUTËZA

Një nga vendet e rëndësishme arkeologjike në Mal të Zi është kalaja e Gjutëzës. Kodra e Gjutëzës ndodhet në vendbanimin Dinoshë, në daljen e lumit të Cemit nga kanioni i gjatë, përgjatë të cilit ka qenë rruga e karvanëve për shekuj me radhë. Në majë të kodrës gjenden mbetjet e arkitekturës fortifikuese nga periudha ilire dhe mesjetare dhe është një nga vendet më të rëndësishme arkeologjike në Mal të Zi. Brenda zonës së fortifikimit ndodhet një kishë njëdhomëshe me absidë gjysmërrethore dhe një vend pagëzimi në anën veriore. Faza e parë e ndërtimit dallohet nga blloqe të mëdha guri të bashkuara me teknikën e murit të thatë, një stil ndërtimi i njohur për kulturën ilire në parahistori dhe antikitet. Në këtë fazë vendbanimi ndahet në një akropol dhe një pjesë për banim. Pjesa veriore dhe jugore e murit të akropolit janë më të ruajturat. Faza e dytë përfaqëson një shtrirje më të vogël të fortifikimit brenda akropolit të vjetër dhe tre kullave më të vogla. Si material lidhës është përdorur llaç hidraulik. Ky lloj ndërtimi është karakteristik për shekullin VI, por mund të datohet edhe më vonë.³

NJËSIA MJEDISORE PRIFTEN

Mbizotërimi i gurit si material ndërtimi është një veçori e kohërave të shkuara dhe një pasqyrim i qëndrimit ndaj pasardhësve - për të lënë si trashëgimi jo vetëm një çati mbi kokë dhe objekte të tjera, por edhe ekzistencën e ndërtimeve me cilësi.

Një nga konfirmimet e kësaj është edhe Prifteni, fshat që tregon se shtëpia ka qenë vendbanim me rëndësi edhe në kuptimin ekonomik - përdorej edhe për ruajtjen e rezervave ushqimore. Përveç faktit

² TUMULLA MONUMENTALE NË KOHË DHE HAPËSIRË - PYETJA E VAZHDIMIT TË NJË VEND KULTI; Prof. dr. Blagoje Govedarica Institut für Prähistorische Archäologie der FU Berlin

³ O. Velimirović-Žižić, Mbetjet e arkitekturës së fortifikimit në Kalanë e Djutezës në Dinoshi afër Titogradit, Materialet 22 - Kongresi XII i Arkeologëve të Jugosllavisë, Novi Sad 1984, f.80-87. na cnrogorski U. Bugaj, P. Lutovac, Z. Polak, M. Trzeciński, M. Novak, Relics of masonry structures on Djuteza Hill, Materialy i Sprawozdania Archeologiczne nr 34, Varshavë 2013, f.149-166



se blloqet e gurit ishin të punuara me kujdes, qemeret në katin përdhes, ballkonet prej guri dhe shkallët e jashtme tregojnë gjithashtu një ndjenjë të zhvilluar dekorimi. Rrugët dhe lëmi, si vende takimi, tregojnë se arkitektura tradicionale e fshatit dallohej edhe nga dimensionimi i jetës në bashkësi. Kjo njësi urbane kompakte sot është e braktisur, por autenticiteti dhe integrimi i saj në peizazh ngjall respekt dhe frymëzim për të qëndruar në një mjedis të tillë. Krahas kësaj tërësie përfaqësuese, konfirmimin e krijimtarisë së jashtëzakonshme arkitekturore në zonë e vërtetojnë edhe mullinjët e shumtë dhe mbetjet e tyre, kanalet, rugicat që lidhin vendbanimet, teknika e tullave e të ngjashme. Dizajni i ndërtesave të sotme ndjek epokën moderne, por kur merr vendime për ndërtimin e shtëpive dhe dekorimin e tyre, mund të dëgjosh vendasit që thonë “le të jetë një atmosferë si ajo në lumin e Cemit”.

SHTËPIA E PRFTËRINJVE I QELËS

Shtëpia e priftërinjve në fshatin Priften ndodhet në Grudë, rreth 16 km nga qendra e Tuzit dhe në afërsi të kishës së Grudës, e cila është ndërtuar në mesin e shekullit të 17-të. Shtëpia e priftërinjve, së bashku me kishën, përfaqëson një tërësi me karakteristika specifike ambientale dhe arkitekturore. E gjithë zona ka qenë e rrethuar me vreshta, por edhe sot ruhet vetëm një numër i vogël hardhish. Në qendër të oborrit gjendet pusi.

MANI I METULOVIT

Pema shekullore e manit në vendbanimin Dinoshë është i njohur për fenomenin e tij të pazakontë - gjatë shirave të dendur, uji buron nga vetë trungu i pemës. Domethënë, në rrënjën e kësaj peme, që i përket familjes së manit, gjendet një burim i cili është hapur dhe pema, në fakt, i shërben atij si një “tub” për shkarkimin e ujit të tepërt.



KISHA E SHËN MHILLIT

Kisha e vjetër famullitare, që së bashku me varrezat dhe kishën e re ndodhet në një mjedis natyror në fushën e vendbanimit Dinoshë, është ndërtuar në shekujt IX dhe XI. Kisha e vjetër është e orientuar në drejtimin lindje-perëndim, e konceptuar si një ndërtesë njëdhomëshe me dy faza ndërtimi të dukshme. Është ndërtuar me blloqe guri me formë të bukur, të radhitur në rreshta të rregullt, materiali i ndërtimit është guri vendas gri në të bardhë. Nga mbetjet e kishës dallohen segmente muresh deri në 2 m të larta, me absidë gjysmërrethore. Në afërsi të kishës ndodhet kisha e restauruar e Shën. Mhillit. Familja Stanaj ka dhuruar fonde për restaurimin e këtij objekti fetar, e kjo në kujtim të të ndjerit Anton Rok Stanaj.⁴

PLLANICA


Të shumta janë veçoritë që lidhen me rrafshnaltën e Pllanicës, që gjendet në anën lindore të fshatit të Dinoshës. Njëra prej tyre është se në majë të kësaj kodre, 200 m mbi lumin e Cemit dhe 267 m mbi nivelin e detit, ka tuma prej guri, domethënë, tuma qendrore, me diametër 15 m dhe lartësi 4 m, dhe katër më të vogla pranë saj. Mund të supozohet se këto varre prehistorike janë bërë në periudhën e epokës së zhvilluar të bronzit. Por kjo lartësi i ka tërhequr njerëzit në një mënyrë tjetër. Këtë e vërteton kalaja në majë të saj, e ndërtuar në shekullin e 19-të, gjatë Perandorisë Osmane. Ky fortifikim u shpall pasuri kulturore e Malit të Zi në vitin 1950. Ai është në formë drejtkëndëshe, me përmasa 35 x 30 m. Është ndërtuar në teknikën e mureve të thatë, me mure deri në 1.5 m të gjerë. Në qendër të saj ndodhet një tumë qendrore. Katër kulla ndihmëse vëzhgimi janë gjithashtu pjesë e fortifikimit dhe aty pranë gjenden mbetjet e një ndërtese tjetër shumë më të vogël. Përveç mbetjeve të kalasë turke, gjenden edhe mbetjet e kalasë austro-hungareze nga Lufta e Parë Botërore.

XHAMIA NE DINOSHË

Xhamia në Dinoshë është një nga më të vjetrat në Malesi. Ajo është ndërtuar në pjesën e sipërme të fshatit në vitin 1770, dhe ka qenë qendër e jetës morale dhe shoqërore.⁵

⁴ ELABORAT I PARAQITJES DHE REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE TË KOMUNËS SË TUZIT

⁵ Autor Bajro Agoviq, "XHAMITË NË MALI të Zi", fq.86, Podgoricë, 2001.



Lumi i Cemit dhe kanioni i tij përfaqësojnë një kombinim të çmuar të bukurisë natyrore dhe trashëgimisë kulturore dhe historike, mbrojtja e të cilave është thelbësore për brezat e ardhshëm. Ruajtja e këtij ekosistemi unik kontribuon jo vetëm në mbrojtjen e biodiversitetit, por edhe në ruajtjen e vlerave tradicionale dhe mënyrës së jetesës së komunitetit vendas. Nëpërmjet menaxhimit të qëndrueshëm dhe sjelljes së përgjegjshme, ne mund të sigurojmë që kjo zonë e jashtëzakonshme të mbetet një burim i paçmuar për të gjithë ata që e vizitojnë dhe e respektojnë atë.

Kjo broshurë u hartua si pjesë e projektit “Kontributi në menaxhimin më efektiv të monumentit natyror Kanioni i Cemit” i zbatuar nga OJQ-ja Parqet Dinarida - Rrjeti i Zonave të Mbrojtura Dinarida dhe financuar nga Fondi i Partneritetit për Ekosistemet Kritike - CEPF. Për përmbajtjen e broshurës mban përgjegjësi vetëm OJQ-ja Parqet Dinarida dhe nuk pasqyron në asnjë mënyrë pikëpamjet e donatorëve.

The Critical Ecosystem Partnership Fund (CEPF) is a joint initiative of l'Agence Française de Développement, Conservation International, the European Union, Fondation Hans Wilsdorf, the Global Environment Facility, the Government of Japan and the World Bank. In the Mediterranean hotspot, additional funding has been provided by the MAVA Foundation, the Audemars-Watkins Foundation, and the Donors' Initiative for Mediterranean Freshwater Ecosystems (DIMFE).

